



VENDIM

Nr. 33, Datë 08/09/2014

"PËR

**MIRATIMIN E KOMISIONEVE TË VLERËSIMIT, NJOHJES DHE EKVIVALENTIMIT
PRANË FAKULTETEVE TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE, PËR PROCESIN E
TRANSFERIMIT TË STUDENTËVE NGA IAL TË CILËVE IU ËSHTË HEQUR LICENCA".**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve në mbledhjen e datës ____/09/2014, në zbatim të nenit 14, të ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe nenit 9, të Statutit të Universitetit të Arteve, Udhëzimit nr. 25, datë 11.08.2014, të MAS, "Për procedurat që do të ndiqen për organizimin e procesit të transferimit të studentëve nga institucionet e arsimit të lartë të cilëve iu është hequr licenca", të Urdhrit nr. 67, datë 28.08.2014, të Rektorit të UART, pasi diskutoi rreth Projekt – Vendimit, "Për miratimin e Komisioneve të Vlerësimit, Njohjes dhe Ekuivalentimit pranë Fakulteteve të Universitetit të Arteve, për procesin e transferimit të studentëve nga IAL të cilëve iu është hequr licenca", paraqitur nga Kryetari i Senatit, Prof. Petrit Malaj,

konstatoj se:

Projekt-Vendimi, "Për miratimin e Komisioneve të Vlerësimit, Njohjes dhe Ekuivalentimit pranë Fakulteteve të Universitetit të Arteve, për procesin e transferimit të studentëve nga IAL të cilëve iu është hequr licenca", është hartuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe aktet nënligjore në fuqi. Mbështetur edhe në diskutimet e anëtarëve të Senatit, Senati Akademik i Universitetit të Arteve,

VENDOSI

1. Miratimin e Komisioneve të Vlerësimit, Njohjes dhe Ekuivalentimit pranë Fakulteteve të Universitetit të Arteve, për procesin e transferimit të studentëve nga IAL të cilëve iu është hequr licenca", me përbërjen si më poshtë vijon:

A. Fakulteti i Arteve të Bukura:

1. Prof. Asc. Edmond Gjokopulli Kryetar
2. Prof. Asc. Genc Mulliqi Anëtar
3. Prof. Asc. Ardian Isufi Anëtar
4. Lektor Petraq Papa Anëtar
5. Lektor Ardian Kapo Anëtar





B. Fakulteti i Muzikës:

- | | |
|------------------------------|---------|
| 1. Prof. Dr. Zana Shuteriqi | Kryetar |
| 2. Prof. Asoc. Fatos Qerimaj | Anëtar |
| 3. Prof. Dr. Ilirjana Dema | Anëtar |
| 4. Prof. Bujar Sykja | Anëtar |
| 5. Prof. Asoc. Dorian Çene | Anëtar |

C. Fakulteti i Artit Skenik:

- | | |
|-------------------------|---------|
| 1. Prof. Kastriot Çausi | Kryetar |
| 2. Prof. Gazmend Gjika | Anëtar |
| 3. Prof. Besnik Bisha | Anëtar |
| 4. Prof. Ilir Martini | Anëtar |
| 5. Prof. Mehmet Xhelili | Anëtar |

2. Miratimin e Sistemit të pikëzimit si më poshtë:

A. Fakulteti i Arteve të Bukura:

Komisioni i Vlerësimit, Njohjes dhe Ekuivalentimit ka në dispozicion 100 pikë për vlerësimin e studentëve aplikantët si më poshtë:

1. Mesatarja e shkollës së mesme20 pikë;
2. Vlerësimi i studimeve universitare pararendëse..... 40 pikë.
3. Performanca (ritmi) i shlyerjes së detyrimeve të ILA pararendëse..... 15 pikë.
4. Testim i aftësive profesionale (artistike) në programin e studimit25 pikë.

B. Fakulteti Artit Skenik:

Komisioni i Vlerësimit, Njohjes dhe Ekuivalentimit ka në dispozicion 100 pikë për vlerësimin e studentëve aplikantë si më poshtë:

1. Mesatarja e shkollës së mesme20 pikë;
2. Vlerësimi i studimeve universitare pararendëse..... 25 pikë.
3. Performanca artistike dhe konkursi specifik55 pikë.

C. Fakulteti i Muzikës:

Komisioni i Vlerësimit, Njohjes dhe Ekuivalentimit për vlerësimin e studentëve aplikantë do të organizojë punën si më poshtë:

I. Faza e parë, shqyrtimi i dosjes së studentit.

- a) Notën mesatare të shkollës së mesme;
- b) Përshtatshmërinë e Curiculave të zhvilluara me ato të FM;
- c) Përshtatshmërinë e sasisë së ECTS për lëndët e njëjta.





- II. Faza e dytë, përbën një test të njohurive praktike sipas programeve të studimit të studentëve aplikantë dhe vitit përkatës të studimeve.
- III. Vlerësimi: Secili nga elementët, (a, b, c, të fazës së parë dhe testi i njohurive praktike, sipas fazës së dytë), të vlerësohen me 100 (njëqind) pikë.
- IV. Pragu i fituesve të jetë 60 pikë, të cilat dalin prej mbledhjes së pikëve të elementëve të veçantë të pjesëtuar me numrin 4 (katër).
3. Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi Z/Rektori për anën mësimore, Dekanët e Fakulteteve, Kryetarja e Degës mësimore e UART;
 4. Komisionet e Vlerësimit, Njohjes dhe Ekuivalentimit, pranë Fakulteteve në UART, të përmbushin me korrektësi kërkesat e Udhëzimit nr. 25, datë 11.08.2014, të MAS, "Për procedurat që do të ndiqen për organizimin e procesit të transferimit të studentëve nga institucionet e arsimit të lartë të cilëve iu është hequr licenca".
 5. Vendimi të pasqyrohet në faqen zyrtare të UART;

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë





SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Petrit MALAJ

Prof. Asoc. Artan PEQINI

Prof. Gazmend LEKA

Prof. Miltian KUTALI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Astrit SELITA

Miranda BAKIASI

Elia PLAKU ADEMI

Enisa VRENOZAJ

Albjan VUKA

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Sokol SHUPO

Prof. Haig ZACHARIAN

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Fatmir MIZIRI

Ramazan GURRA

Kristina AGO

